



A.nr. 500/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.500/2026, të datës 05.05.2026, të parashtruar nga ankuesi I.T, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 29.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.500/2026, e datës 05.05.2026 e parashtruar nga ankuesi I.T, ashtu që, **detyrohet** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë shqyrtimin e kërkesës me numër protokolli 05-1339 të datës 03.03.2026 të parashtruar nga ankuesi, dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi I.T,(*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), me datë 28.04.2026, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 05.05.2026, lidhur me nivelizimin e koeficientit, shtesës për pozitën e Kryeinspektorit Sanitar(Udhëheqës i Inspektoratit Sanitar të Kosovës) me drejtuesit e tjerë të nivelit qendror, nivelizimin e koeficientit të të gjithë inspektorëve sanitar, zbatimin e shtesës prej 250 Euro në mënyrë retroaktive nga janari 2024, Kompensimin e orëve shtesë të realizuara, Rishqyrtimin e gradimit dhe kategorizimin e pozitës sipas përgjegjësive reale dhe rimbursimin retroaktiv të diferencës së koeficientit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Kolegji i Këshillit*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 12.05.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Shëndetësisë, ndërsa, kjo e fundit, më datë 15.05.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje administroi këto prova: Ankesa me numër protokollit 2166/2026 të datës 05.05.2026, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën me numër protokollit 05-1339 të datës 03.03.2026 të parashtruar nga ankuesi tek Ud. Sekretari i Përgjithshëm i MSH; Kërkesën e datës 22.04.2024 e parashtruar nga ankuesi tek Sekretari i Përgjithshëm i MSH; Listën e Inspektorëve të Regjionit të Gjilanit, Prizrenit, Pejës, Ferizajt, Mitrovicës, Prishtinës; Zarfën e datës 28.04.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.05.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 15.05.2026; Akt emërimit e datës 31.01.2013 të ankuesit; Emailin e datës 06.02.2026 nga ankuesi për V.H; Listë të pagave për ankuesin 01.01.2026 deri 31.05.2026; Memorandumin e mirëkuptimit për transferimin e Inspektorëve Sanitar i datës 12.10.2023; Plani i datës 16.01.2024 nga ora 18:30; Pallni i datës 16.02.2024; Plani i datës 17.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 18.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 19.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 23.01.2024 nga ora 19:30; Pani I datës 24.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 25.01.2024 nga ora 19:30; Plani I datës 26.01.2024 nga ora 19:30; Plani I datës 29.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 30.01.2024 nga ora 19:30; Plani I datës 31.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 09.01.2024 nga ora 19:00; Plani i datës 10.01.2024 nga ora 19:30; Plani I datës 05.02.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 02.02.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 11.01.2024 nga ora 19:30; Plani operativ i datës 12.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 12.02.2024; Plani i datës 14.02.2024; Plani i datës 15.01.2024 nga ora 19:30; Plani i datës 15.02.2024.

Kolegji i Këshillit, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, ka konstatuar se meqenëse nuk është nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e ankuesit, atëherë ekziston baza ligjore që të detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi lidhur me shqyrtimin e kërkesës numër protokollit 05-1339 të datës 03.03.2026 të parashtruar nga ankuesi, *sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 31.01.2013, mban pozitën Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit Sanitar, fillimisht në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, mirëpo sipas Memorandumit të Mirëkuptimit për Transferimin e Inspektorëve Sanitar të datës 12.10.2023 të lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Inspektorët Sanitar janë transferuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë në Ministrinë e Shëndetësisë, dhe atë nga data 01.11.2023.

Ankuesi, më datë 03.03.2026 përmes kërkesës me numër protokollit 05-1339 i është drejtuar u.d Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me kërkesë për nivelizimin e koeficientit, zbatimin e shtesave sipas rregulloreve në fuqi dhe kompensimin e orëve shtesë për Inspektoratin Sanitar, mirëpo sipas provave të lëndës, nuk ka marr përgjigje në kërkesën e tij.

Kundër heshtjes administrative, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se janë duke u dëmtuar duke kërkuar, nivelizimin e koeficientit për të gjithë Inspektorët Sanitar dhe Kryeinspektorin Sanitar i cili duhet të trajtohet njëjtë si drejtuesit e tjerë të nivelit qendror, zbatimin e shtesës prej 250 Euro në mënyrë retroaktive nga janari 2024, Kompensimin e orëve shtesë të realizuara, Rishqyrtimin e gradimit dhe kategorizimit të pozitës sipas përgjegjësi dhe rimbursimin retroaktive të diferencës së koeficientit.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me rregullat e veprimeve procedurale të një organi publik, me rastin e vendimmarrjes ju referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (tutje referuar: LPPA), përkatësisht nenit 10 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *“2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative”*, nenit 98 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur; por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj”*, si dhe nenit 97 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ apo lidhjen e një kontrate administrative, dhe si rrjedhojë në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes”*, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi përkatës i punësimit, në rrethanat e rastit konkret, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat përkatëse ligjore, në raport me kërkesën me numër protokolli 05-1339 të datës 03.03.2026 të parashtruar nga ankuesi, ngase sipas bazës ligjore si me sipër, vullneti i organit publik në realizimin e autoritetit publik formësohet në procedurë administrative dhe manifestohet në formën e njërit prej veprimeve administrative, siç janë: akti administrativ; kontrata administrative apo akti real, dhe se në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, organi përkatës i punësimit, në kuadër të autorizimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, është dashur që të nxjerr akt administrativ në kuptim të vendosjes dhe të njoftoj palën për aktin e tillë, brenda një afati prej 45 ditësh sikurse përcaktohet me nenin 98 paragrafi 2 apo afatit të vazhduar sipas nenit 99 paragrafi 1 të LPPA-së.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, heshtja e organit të administratës, në këtë rast, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë në raport me kërkesën me numër protokolli 05-1339 të datës 03.03.2026, cenon të drejtat e ankuesit në kuptimin e të drejtave procedurale dhe për rrjedhojë edhe vendosjes në mënyrë meritore, ngase ashtu sikurse është thënë në arsyetim të këtij vendimi, në kërkesën e parashtruar të organi i punësimit, ankuesi pretendon realizimin e të drejtës lidhur me pagën, shtesën prej 250 euro, shtesën për orët shtesë dhe kompensimin retroaktiv të tyre.

Kështu që, nga ajo që u konstatua si më lartë e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të aprovoj si të bazuar në kuptim të shkeljeve procedurale, dhe si rrjedhojë detyroj Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, që në respektim të dispozitave procedurale të shqyrtoj kërkesën numër protokolli 05-1339 të datës 03.03.2026 të ankuesit dhe të nxjerr akt administrativ në përputhshmëri me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.500/2026, më datë 29/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit I.T;
- Organit të punësimit: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së;